

LIGJ
Nr.9884, datë 28.2.2008

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.5659, datë 11.3.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË
PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR
(1998, 2001 DHE 2006)

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,

në frymën e marrëdhënieve miqësore ekzistuese ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore ndërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje, me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare të datës 5 dhjetor 2001 dhe të datës 12 shtator 2006 në Tiranë,

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe/ose marrësve të tjerë që do të zgjidhen bashkërisht nga të dy Qeveritë, të marrin nga Kreditansalt fur Wiederaufbau, Frankfurt mbi Majn, një shumë financimi me vlef të prej gjithsej 3 556 000 euro (me fjalë: tre milionë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë euro) për projektin “Rezervati ndërkufitar i biosferës në Prespë”, kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen

për t'u mbështetur.

2. Nëse Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë bien dakord, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditansalt fur Wiederaufbau shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo Marrëveshje.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratën që do të lidhet midis Kreditansalt fur Wiederaufbau dhe marrësve të shumës së financimit, kontratë e cila u nënshtrohet dispozitave ligjore në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1 do të zhvleftësohet, në rast se kontrata përkatëse për financim nuk përfundohet brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit përkatës të premtimit. Për shumën e pjesshme nga viti i premtimit 1998, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2006, për shumën e pjesshme nga viti i premtimit 2001, afati mbaron në datën 31 dhjetor 2009, për shumën e pjesshme nga viti i premtimit 2006, afati mbaron në datën 31 dhjetor 2014.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai nuk është vetë marrësi i shumës së financimit, do të garantojë ndaj Kreditansalt fur Wiederaufbau pretendime eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratës për financim, e cila do të përfundohet sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditansalt fur Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë, lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratës së përmendur në nenin 2.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, transport ky që rezulton nga dhënia e shumës së financimit, si dhe nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rast se duhet lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më datën 16.1.2008 në dy kopje origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.